



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 91

Ora: 11:10

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 56, DATË 10.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë"

OBJEKT: Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 472, datë 09.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 392 nga koalicioni Bashkë Fitojmë, për afishimin e materialeve propagandistike në kundërshtim të ligjit nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në aksin rrugor kombëtar Elbasan-Librazhd, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023";



BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 56 regj., datë 10.05.2023. Në mbledhjen e datës 11.05.2023, ora 11:10, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 56 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 56, datë 10.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 11.05.2023, ora 15:15.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli **BELE** - **Relator**

Ilirjan **RUSMALI** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**